

**Marrëveshja e Vjenës
për klasifikimin ndërkombëtar të elementëve
figurativ të markave tregtare**

**Përpiluar në Vjenë më 12 qershor të vitit 1973
si dhe e ndryshuar dhe plotësuar më 1 tetor të vitit 1985**

Shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 19/10

Palët nënshkruese,

Duke marrë parasysh nenin 19 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale të 20 marsit të vitit 1883, e rishikuar në Bruksel më 14 dhjetor të vitit 1900, në Uashington më 2 qershor të vitit 1911, në Hagë më 6 nëntor të vitit 1925, në Londër më 2 qershor të vitit 1934, në Lisbonë më 31 tetor të vitit 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Themelimi i Unionit të veçantë;
Aprovimi i Klasifikimit ndërkombëtar

Vendet në të cilët zbatohet kjo marrëveshje e formojnë unionin e veçantë dhe pranojnë klasifikimin e përbashkët për elementët figurativ të markave tregtare (në tekstin e mëposhtëm: “Klasifikimi i elementëve figurativ”).

Neni 2
Definimi dhe deponim i i Klasifikimit të elementëve figurativ

(1) Klasifikimi i elementëve figurativ përbëhet nga lista e kategorive, klasave dhe nënklasave në të cilat klasifikohen elementët figurativ të markave tregtare, bashkë me shpjegime, në qoftë se kjo është e nevojshme.

(2) Klasifikimi i elementëve figurativ është përpiluar në një dokument origjinal në gjuhën angleze dhe franceze, i nënshkruar nga dhe i deponuar tek drejtori gjeneral i Organizatës botërore për pronësi industriale (në tekstin e mëposhtëm “Drejtori gjeneral” dhe “Organizata”) në momentin kur kjo marrëveshje është hapur për nënshkrim.

(3) Ndryshimet dhe plotësimet e nenit 5 paragrafi (3) (i) gjithashtu do të përpilohen në një dokument origjinal në gjuhën angleze dhe franceze, të nënshkruar nga dhe të deponuar tek drejtori gjeneral.

Neni 3

Gjuhët e Klasifikimit të elementëve figurativ

(1) Klasifikimi i elementëve figurativ është përpiluar në gjuhën angleze dhe franceze, ndërkohë që të dy tekstet janë njëtrajtësisht autentik.

(2) Byroja ndërkombëtare e Organizatës (në tekstin e mëposhtëm: “Byroja ndërkombëtare”) në konsultime me qeveritë e interesuara do të përpilojë tekst zyrtar të Klasifikimit të elementëve figurativ në gjuhët të cilat mund t’i caktojë Kuvendi nga neni 7 në përputhje me paragrafin (2) (a) (vi) të atij neni.

Neni 4

Përdorimi i Klasifikimit të elementëve figurativ

(1) Në pajtim me kushtet e parapara me këtë marrëveshje, vëllimi i klasifikimit të elementëve figurativ është ai që do ta përcaktojë secili vend i unionit të veçantë. Më saktësisht, Klasifikimi i elementëve figurativ nuk i obligon vendet e unionit të veçantë lidhur me vëllimin e mbrojtjes së markës tregtare.

(2) Entet përgjegjëse në vendet e unionit të veçantë kanë të drejtë ta përdorin Klasifikimin e elementëve figurativ si sistem kryesor apo ndihmës.

(3) Entet përgjegjëse të vendeve të unionit të veçantë në dokumentet dhe shpalljet zyrtare që kanë të bëjnë me regjistrimin e markave tregtare dhe vazhdimin e tyre, do t’i fusin numrat e kategorive, klasave dhe nënklasave në të cilat duhet të caktohen (ndahen) elementët figurativ të asaj marke tregtare.

(4) Para atyre numrave duhet të qëndrojnë fjalët: “Klasifikimi i elementëve figurativ” ose shkurtesa të cilën e përcakton Komiteti i ekspertëve nga neni 5.

(5) Çdo vend në kohën e nënshkrimit ose deponimit të instrumentit për ratifikim ose aderim mund të deklarojë se nuk obligohet t’i përfshijë numrat në të gjitha ose në disa klasa në dokumentet dhe shpalljet zyrtare që kanë të bëjnë me regjistrimin e markave tregtare dhe vazhdimin e tyre.

(6) Në qoftë se ndonjë vend nga unioni i veçantë ia beson regjistrimin e markave tregtare ndonjë trupi ndërqeveritar, ai do t’i ndërmerr të gjitha masat për të siguruar që ai trup të shfrytëzojë Klasifikimin e elementëve figurativ në pajtim me këtë nen.

Neni 5

Komiteti i ekspertëve

(1) Do të themelohet Komiteti i ekspertëve në të cilin do të përfaqësohet çdo vend i Unionit të veçantë.

(2)(a) Drejtori gjeneral mund, dhe nëse këtë e kërkon Komiteti i ekspertëve, të ftojë edhe vendet që nuk janë anëtare të Unionit të veçantë, ndërsa janë anëtarë të Organizatës ose Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, si vëzhgues të marrin pjesë në takimet e Komitetit të ekspertëve.

b) Drejtori gjeneral do t'i ftojë organizatat ndërqeveritare të specializuara në fushën e markave tregtare, prej të cilave të paktën një nga vendet anëtare është palë e Marrëveshjes, që të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Komitetit të ekspertëve.

c) Drejtori gjeneral mund, dhe nëse këtë e kërkon Komiteti i ekspertëve, t'i ftojë edhe organizatat joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare të marrin pjesë në diskutime në interes të tyre.

(3) Komiteti i ekspertëve do të:

(i) kryej ndryshime dhe plotësime të Klasifikimit të elementëve figurativ;

(ii) dërgojë deri tek vendet e Unionit të veçantë rekomandime me qëllim lehtësimin e përdorimit të Klasifikimit të elementëve figurativ dhe promovimit të zbatimit të unifikuar.

(iii) ndërmerr të gjitha masat tjera që pa implikime financiare të buxhetit të Unionit të veçantë ose të Organizatës, do të kontribuojnë për lehtësimin e zbatimit të Klasifikimit të elementëve figurativ në vendet në zhvillim;

(iv) ketë të drejtë të themelojë nënkomitetet dhe grupe punuese.

(4) Komiteti i ekspertëve sjell rregullore të vet. Rregullorja parashikon mundësi për pjesëmarrje të organizatave ndërqeveritare për të cilat bëhet fjalë në paragrafin (2) (b) në takimet e nënkomiteteve dhe grupeve punuese të Komitetit të ekspertëve, të cilët mund dukshëm të kontribuojnë në zhvillimin e Klasifikimit të elementëve figurativ.

(5) Propozime për ndryshime ose plotësime të Klasifikimit të elementëve figurativ mund të jep enti përgjegjës i çdo vendi të Unionit të veçantë, Byrosë ndërkombëtare, çdo organizate ndërqeveritare të përfaqësuar në Komitetin e ekspertëve në pajtim me paragrafin 2(b) dhe çdo shtet apo organizatë e ftuar në veçanti nga Komiteti i ekspertëve, që të dorëzojë propozime të tilla. Propozimet e dorëzuara deri te Byroja ndërkombëtare u dërgohen anëtarëve të Komitetit të ekspertëve dhe vëzhguesve, jo më vonë se 2 muaj para fillimit të seancës së Komitetit të ekspertëve në të cilën ato propozime do të shqyrtohen.

(6)(a) Çdo vend anëtarë i Komitetit të ekspertëve ka një votë.

(b) Komiteti i ekspertëve sjell vendim me shumicë të thjeshtë të votave të vendeve që janë të përfaqësuara dhe që votojnë.

(c) Çdo vendim, i cili sipas mendimit të një të pestës së vendeve përfaqësuese të cilët votojnë kërkon ndryshim strukturën themelore të Klasifikimit të elementëve figurativ ose riklasifikim esencial, merret (sillet) me shumicë prej tre të katërtave të votave të vendeve që janë të përfaqësuara dhe që votojnë.

(d) abstenimi nuk llogaritet si votim.

Neni 6

Njoftimi, hyrja në fuqi dhe shpallja e ndryshimeve dhe plotësimeve dhe vendimeve të tjera

(1) Për çdo vendim të Komitetit të ekspertëve në lidhje me pranimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Klasifikimit të elementëve figurativ si edhe rekomandimeve të Komitetit të ekspertit, Byroja ndërkombëtare do t'i njoftojë entet përgjegjëse të vendeve të Unionit të veçantë. Ndryshimet dhe plotësimet do të hyjnë në fuqi 6 muaj nga dita kur është dërguar njoftimi.

(2) Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve, Byroja ndërkombëtare do t'i fus në Klasifikimin e elementëve figurativ. Ndryshimet dhe plotësimet shpallen në publikimet të cilat do t'i përcaktojë Kuvendi sipas nenit 7.

Neni 7

Kuvendi i Unionit të veçantë

(1)(a) Unioni i veçantë ka Kuvend të cilin e përbëjnë vendet e Unionit të veçantë.

(b) Qeveria e çdo vendi të Unionit të veçantë do të përfaqësohet me një delegat, të cilit mund t'i ndihmojnë delegatë – këshilltarë dhe ekspertë.

(c) Çdo organizatë ndërqeveritare nga neni 5 paragrafi (2)(b) mund të përfaqësohet me vëzhgues në takimet e Kuvendit, dhe nëse Kuvendi vendos ashtu, në ato komitete dhe grupe punuese që mund t'i themelojë Kuvendi.

(d) Shpenzimet për çdo delegat janë barrë e qeverisë e cila e ka emëruar.

(2)(a) Në pajtim me dispozitat e nenit 5, Kuvendi do të:

(i) merret me të gjitha punët e lidhura me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të veçantë dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje;

(ii) jep udhëzime deri te Byroja ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet e konferencave për rishikim;

(iii) rishqyrtojë dhe vërtetojë raportet dhe aktivitetet e drejtorit gjeneral në lidhje me Unionin e veçantë dhe do t'i jep instruksionet e domosdoshme në lidhje me punimet në kuadër të përgjegjësive të Unionit të veçantë;

(iv) caktojë programin dhe miratoj buxhetin dyvjeçar të Unionit të veçantë dhe miraton llogarinë e tij përfundimtar;

(v) miraton Rregulloren për punë financiare të Unionit të veçantë;

(vi) vendos për sjelljen e teksteve zyrtare të Klasifikimit të elementëve figurativ në gjuhë të ndryshme nga ajo angleze dhe franceze;

(vii) themelojë komitete dhe grupe punuese të tilla që vlerëson se janë adekuate për realizimin e qëllimeve të Unionit të veçantë;

(viii) vendos, në pajtim me paragrafin (1) (c), se cilave vendeve që nuk janë anëtarë të Unionit të veçantë dhe cilave organizatave joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare do t'u lejohet të jenë vëzhgues në takimet e tyre dhe në komitetet apo grupet punuese tjera që ai ka themeluar;

(ix) ndërmerr aktivitete të tjera përkatëse me qëllim realizimi të qëllimeve të Unionit të veçantë;

(x) kryen të gjitha obligimet tjera në pajtim me këtë marrëveshje.

(b) Në lidhje me çështjet që janë në interes të unioneve të tjera me të cilat udhëheq Organizata, Kuvendi do të sjell vendim pasi që të konsultohet me Trupin koordinues të Organizatës.

(3)(a) Çdo vend anëtarë ka një votë.

(b) Njëra gjysmë e vendeve anëtare të Kuvendit e përbëjnë kuorumin.

(c) Në mungesë të kuorunit, Kuvendi mund të sjellë vendim, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me vetë punën e tij. Të gjitha këto vendime prodhojnë efekt vetëm nëse janë plotësuar kushtet e cekura tekstin e mëposhtëm. Byroja ndërkombëtare i dorëzon vendimet e dhëna deri tek vendet anëtare të Kuvendit, që nuk kanë qenë të pranishëm dhe i fton që me shkrim të deklarohen në lidhje me

votimin e tyre ose të abstenojnë, në afat prej tre muajve nga dita e dërgimit. Në qoftë se në këtë afat, numri më i madh i vendeve deklarohen rreth votimit të tyre ose abstenojnë dhe me këtë arrihet numri i vendeve që ka munguar për arritjen e kuorumit në vetë seancën, vendimet e tilla prodhojnë efekt, me kusht që njëkohësisht të jetë arritur shumica e nevojshme.

(d) Në pajtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi (2) Kuvendi sjell vendim me shumicë prej dy të tretave të votave të dhëna.

(e) Abstenimi nuk llogaritet si votë.

(f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe të votojë në emër të vetëm një vendi.

(4)(a) Kuvendi do të mbledhet një herë në çdo të dytin vit kalendarik në seancë të rregullt të cilën e thërret drejtori gjeneral, edhe atë, me përjashtim të kushteve të jashtëzakonshme, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend si edhe Kuvendi gjeneral i Organizatës

(b) Kuvendi do të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me iniciativë të drejtorit gjeneral, me kërkesë të një të katërtës së vendeve anëtare të Kuvendit.

(c) Rendin ditor për çdo seancë e përgatit drejtori gjeneral.

(5) Kuvendi sjell rregullore të vet të punës.

Neni 8

Byroja ndërkombëtare

(1)(a) Punët administrative të Unionit të veçantë i kryen Byroja ndërkombëtare.

(b) Më saktësisht, Byroja ndërkombëtare përgatit mbledhjet (takimet) dhe u siguron sekretariat për Kuvendin, Komitetin e ekspertëve dhe trupat tjerë apo grupet punuese që mund t'i formojë Kuvendi ose Komiteti i ekspertëve.

(c) Drejtori gjeneral është president i Unionit të veçantë dhe e përfaqëson Unionin e veçantë.

(2) Drejtori gjeneral dhe cilido qoftë nëpunës tjetër i emëruar nga ai do të marr pjesë pa të drejtë vote në të gjitha takimet e Kuvendit, Komitetit të ekspertëve dhe trupave tjerë apo grupeve punuese që mund t'i formojë Kuvendi ose Komiteti i ekspertëve.

Drejtori gjeneral ose cilido qoftë nëpunës tjetër të cilin ai do ta emërojë sipas detyrës zyrtare është sekretar i atyre trupave.

(3)(a) Byroja ndërkombëtare, në pajtim me udhëzimet e Kuvendit, i kryen përgatitjet për konferenca rishikuese.

(b) Byroja ndërkombëtare në lidhje me përgatitjet për konferencat rishikuese mund të konsultohet me organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare.

(c) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga ai do të marrin pjesë në diskutimet e konferencave rishikuese, pa të drejtë vote.

(4) Byroja ndërkombëtare do t'i kryej të gjitha punët tjera që i janë besuar.

Neni 9 Financat

(1)(a) Unioni i veçantë ka buxhetin e tij.

(b) Buxheti i Unionit të veçantë përmban të hyrat vetanake dhe shpenzimet e Unionit të veçantë, pjesëmarrjen e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta të Unionit me të cilin menaxhon Organizata, e sipas nevojës edhe shumën që është në diskutim të buxhetit të Konferencës së Organizatës.

(c) Shpenzimet të cilat nuk mund t'i përshkruhen në veçanti unionit të veçantë, por një ose më shumë unioneve me të cilat menaxhon Organizata, do të konsiderohen si shpenzime të përbashkëta të unioneve. Pjesëmarrja e Unionit të veçantë në këto shpenzime të përbashkëta është proporcionale me interesin e tij nga ato.

(2) Buxheti i Unionit të veçantë do të përcaktohet ashtu që do të merren parasysh nevojat për harmonizim me buxhetin e unioneve të tjera të menaxhuara nga Organizata.

(3) Buxheti i Unionit të veçantë do të financohet nga burimet në vijim:

(i) kontributet nga vendet anëtare të Unionit të veçantë;

(ii) shpenzimet dhe pagesat për shërbimet që i jep Byroja ndërkombëtare në lidhje me Unionin e veçantë;

(iii) mjete të realizuara nga shitja ose kompensimi për publikimet e Byrosë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Unionin e veçantë;

(iv) dhurata, donacione dhe subvencione;

(v) qiraja, interesi dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

(4)(a) Që të vërtetohet pjesëmarrja e tij sipas paragrafit (3) (i), çdo vend i Unionit të veçantë duhet t'i takojë të njëjtës klasë në të cilën i takojnë në Unionin e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale dhe do t'i paguajë kontributet e veta vjetore në bazë të numrit të njëjtë të njësive që është përcaktuar për atë klasë në atë union.

(b) Kontributi vjetor i çdo shteti të Unionit të veçantë është shuma që në raport me shumën e përgjithshme të kontributeve të të gjitha vendeve në buxhetin e Unionit të veçantë, është identik si raporti i numrit të njësive të tij në raport me numrin e përgjithshëm të njësive të të gjithë vendeve që paguajnë kontribute.

(c) Kontributet maturohen më 1 janar të çdo viti.

(d) Vendi që vonohet me pagesën e kontributeve të veta nuk mund të realizojë të drejtën e vetë të votës në asnjë trup të Unionit të veçantë, në qoftë se shuma e papaguar është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve të cilën është e obliguar ta paguaj për dy vitet paraprake. Megjithatë, çdo trup i Unionit të veçantë mund të atij vendi t'i mundësojë të drejtën e votës në atë trup nëse dhe derisa është plotësuar kushti se deri tek vonesa në pagesë është arritur si shkak i rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

(e) Në qoftë se buxheti nuk është miratuar para fillimit të periudhës së re financiare, ai mbetet në nivelin e buxhetit të vitit paraprak, siç është parashikuar me rregulloren financiare.

(5) Shuma e shpenzimeve dhe pagesave që paguhet për shërbime që i ofron Byroja ndërkombëtare Unionit të Veçantë përcaktohet nga drejtori gjeneral dhe për këtë e njofton Kuvendin.

(6)(a) Unioni i veçantë ka fond për kapital punues (qarkullues) që përbëhet nga pagesa të veçanta nga secili vend i Unionit të veçantë. Në qoftë se ky fond tregohet i pamjaftueshëm, Kuvendi sjell vendim për rritjen e tij.

(b) Shuma e pagesës së parë në fondin e cekur ose pjesëmarrja në rritjen e tij do të jetë në raport me kontributin e vendit për vitin në të cilin fondi është themeluar ose në të cilin është sjellë vendimi për rritjen e tij.

(c) Raportin dhe kushtet e pagesës i përcakton Kuvendi me propozim të drejtorit gjeneral pas këshillimit të mëparshëm me Komitetin koordinues të Organizatës.

(7)(a) Marrëveshja e nënshkruar në selinë e vendit në territorin e të cilit ka selinë Organizata, parashikon që, kur fondi i kapitalit punues të jetë i pamjaftueshëm, ai vend të jep avanse. Lartësia e këtyre avanseve dhe kushtet në bazë të të cilave miratohen janë lëndë për secilin rast të marrëveshjeve të veçanta midis atij vendi dhe Organizatës.

(b) Vendi i cekur në pikën (a) si edhe Organizata kanë të drejtë ta anulojnë obligimin për dhënie avansi, përmes njoftimit me shkrim. Anulimi prodhon efekt tre vite pas nga fundi i vitit në të cilin është bërë njoftimi.

(8) Revizionin (Auditimin) e llogarive e kryejnë një ose më shumë vende të Unionit të veçantë ose revizor (auditor) i jashtëm, siç është parashikuar me Rregulloren për punë financiare. Ata, me pajtimin e tyre, emërohen nga Kuvendi.

Neni 10

Rishikimi i marrëveshjes

(1) Kjo marrëveshje mund të rishikohet periodikisht, në konferencë të veçantë të vendeve të Unionit të veçantë.

(2) Për thirrje të çdo konference rishikuese vendos Kuvendi.

(3) Nenet 7, 8, 9 dhe 11 mund të ndryshohen ose plotësohen ose në konferencë rishikuese ose në pajtim me dispozitat në nenin 11.

Neni 11

Ndryshime dhe plotësime të dispozitave të caktuara të marrëveshjes

(1) Propozim për ndryshim ose plotësim të neneve 7, 8, 9 dhe të këtij neni mund të bëjë çdo vend i Unionit të veçantë ose drejtori gjeneral. Këto propozime, drejtori gjeneral do t'i dorëzojë deri tek vendet e Unionit të veçantë, të paktën 6 muaj para shqyrtimit të tyre në kuvend.

(2) Ndryshimet dhe plotësimet e neneve nga paragrafi (1) i miraton Kuvendi. Për miratim nevojiten tri të katërtat e votave të dhëna, derisa për çdo ndryshim dhe plotësim të nenit 7 si edhe të këtij neni nevojiten katër të pestat e votave të dhëna.

(3)(a) Çdo ndryshim dhe plotësim ndaj neneve të cekura në paragrafin (1) do të hyjë në fuqi pas skadimit të periudhës prej një muaji nga dita kur drejtori gjeneral do t'i

pranojë njoftimet me shkrim për pranimin e ndryshimeve dhe plotësimeve nga tri të katërtat e vendeve të Unionit të veçantë, të përbërë (proceduara) në pajtim me procedurat e tyre adekuate kushtetuese.

(b) Çdo ndryshim dhe plotësim i pranuar në atë mënyrë në nenet e cekura i obligon të gjitha vendet që janë anëtarë të Unionit të veçantë, në momentin e hyrjes së tyre në fuqi, ndërkohë që çdo ndryshim dhe plotësim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit të veçantë i obligon vetëm ato vende që janë deklaruar se i pranojnë ato ndryshime dhe plotësime.

(c) Çdo ndryshim dhe plotësim i pranuar në pajtim me dispozitat e nënparagrafit (a) i obligon të gjitha vendet që janë bërë anëtarë të Unionit të veçantë pas datës në të cilën kanë hyrë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet, në pajtim me dispozitat e nënparagrafit (a).

Neni 12 **Të bërit pjesë (palë) e Marrëveshjes**

(1) Çdo vend anëtarë i Konventës së Parisit mund të bëhet palë e kësaj marrëveshje përmes:

- (i) nënshkrimit, pas së cilit pason deponimi i instrumentit të ratifikimit, ose
- (ii) deponimit të instrumentit për aderim (qasje apo anëtarësim).

(2) Instrumenti për ratifikim ose aderim deponohet tek drejtori gjeneral.

(3) Dispozitat nga neni 24 i Aktit të Stokholmit të Konventës së Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale zbatohen në këtë marrëveshje.

(4) Paragrafi (3) në asnjë rast nuk duhet të kuptohet se një vend i Unionit të veçantë njih ose në heshtje pranon gjendjen faktike në lidhje me territorin e vendit tjetër që zbaton këtë marrëveshje, në bazë të paragrafit të cekur.

Neni 13 **Hyrja në fuqi e Marrëveshjes**

(1) Në lidhje me pesë vendet e para që kanë deponuar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim, kjo marrëveshje hyn në fuqi tre muaj nga deponimi i instrumentit të pestë për ratifikim ose aderim.

(2) Në lidhje me çdo vend, me përjashtim atyre që në Marrëveshje kanë hyrë në fuqi sipas paragrafit (1), kjo marrëveshje hyn në fuqi tre muaj nga data kur drejtori gjeneral ka dërguar njoftim për ratifikimin ose aderimin e atij vendi, me përjashtim, nëse në instrumentin për ratifikim ose aderim të jetë caktuar një datë e mëvonshme. Në atë rast, kjo marrëveshje në raport me atë vend hyn në fuqi në datën në të cilën është caktuar.

(3) Ratifikimi ose aderimi nënkupton pranimin e të gjitha klauzolave dhe arritjen e të gjitha përfitimeve nga kjo marrëveshje.

Neni 14 **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka të njëjtën kohëzgjatje si edhe Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale.

Neni 15 **Anulimi**

(1) Çdo vend i Unionit të veçantë mund të heqë dorë nga kjo marrëveshje përmes njoftimit drejtuar deri te drejtori gjeneral.

(2) Anulimi (tërheqja) hyn në fuqi një vit nga dita kur drejtori gjeneral ka pranuar njoftimin.

(3) Të drejtën për anulim (tërheqje) të paraparë me këtë nen nuk mund ta zbatojë asnjë vend para skadimit të periudhës prej pesë viteve nga data kur ai është bërë anëtarë i Unionit të veçantë.

Neni 16 **Konteste**

(1) Çdo kontest midis dy apo më shumë vendeve të Unionit të veçantë, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e që nuk është zgjidhur me bisedime, mundet nga ana e cilitdo vend të përfshirë të paraqitet para Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë në pajtim me statutin e gjykatës për ta zgjidhur atë kontest, me përjashtim të rastit kur vendet për të cilat ka të bëjë kontesti merren vesh përmes metodave të tjera. Vendi që del para gjykatës duhet ta njoftojë Byroën ndërkombëtare, ndërsa Byroja ndërkombëtare për këtë do t'i informojë të gjitha vendet e Unionit të veçantë.

(2) Çdo vend, në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ose të deponimit të instrumentit për ratifikim ose aderim, mund të deklarohet se nuk llogaritet e obliguar

me dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni. Dispozitat nga paragrafi (1) nuk zbatohen në konflikte midis cilitdo vend që ka dhënë deklaratë të tillë dhe që ka qenë vend i Unionit të veçantë.

(3) Çdo vend që ka dhënë deklaratë sipas dispozitave nga paragrafi (2) në çdo moment mund ta tërheq deklaratën e tij përmes njoftimit drejtuar deri te drejtori gjeneral.

Neni 17 **Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e deponimit, njoftimet**

(1) (a) Kjo marrëveshje nënshkruhet në një dokument origjinal në gjuhën angleze dhe franceze, ndërkohë që të dy tekstet janë njëlloj autentik.

(b) Kjo marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor të vitit 1973 në Vjenë.

(c) Dokumenti origjinal i kësaj marrëveshje, pas skadimit të afatit në të cilin është i hapur për nënshkrime dërgohet tek drejtori gjeneral.

(2) Tekstet zyrtare në gjuhë të tjera që mund t'i përcaktojë Kuvendi, i vërteton (aprovon) drejtori gjeneral pas këshillimit të kryer me qeveritë e interesuara.

(3)(a) Drejtori gjeneral vërteton dhe dorëzon dy kopje të tekstit të nënshkruar të kësaj marrëveshje deri te qeveritë e vendeve që kanë nënshkruar atë dhe me kërkesë, deri te qeveria e cilitdo vend.

(b) Drejtori gjeneral vërteton dhe dorëzon dy kopje të çdo ndryshimi të kësaj marrëveshje deri te qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit të veçantë dhe me kërkesë, deri te qeveria e cilitdo vend.

(c) Drejtori gjeneral sipas kërkesës dërgon deri te qeveria e çdo vend që ka nënshkruar këtë marrëveshje ose që ka aderuar, dy kopje të vërtetuara nga Klasifikimi i elementëve figurativ në gjuhën angleze dhe franceze.

(4) Drejtori gjeneral e regjistron këtë marrëveshje në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara.

(5) Drejtori gjeneral i njofton qeveritë e të gjitha vendeve, palë nënshkruese të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, për:

(i) nënshkrimet, në pajtim me paragrafin (1);

- (ii) deponimin e dokumenteve për ratifikim ose aderim, në pajtim me nenin 12 paragrafin (2);
- (iii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, në pajtim me nenin 13 paragrafi (1);
- (iv) deklaratat e dhëna, në pajtim me nenin 4 paragrafi (5);
- (v) deklaratat në lidhje me njoftimet, të dhëna në pajtim me nenin 12 paragrafi (3);
- (vi) deklaratat e dhëna, në pajtim me nenin 16 paragrafi (2);
- (vii) tërheqja e cilësdo deklaratë të dhënë në pajtim me nenin 16 paragrafi (3);
- (viii) pranimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të kësaj marrëveshje, në pajtim me nenin 11 paragrafi (3);
- (ix) datat në të cilat hyjnë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet;
- (x) anulime (tërheqje) të pranuar, në pajtim me neni 15.